



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	<u>DMM</u>
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No	<u>1612-2/26</u>
Nr. i faqeve Broj stranica No pages	<u>04</u>
Data Datum Date	<u>03.09.2026</u>
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	28.08.2026
REFERENC-Ë:	26/1612/301/DMM
PËR/ZA/TO:	"Start Projekt" Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/1612/301/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Përfundim të Procedurës Administrative** për kërkesën e kompanisë "Start Projekt" Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren - për shfrytëzimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit në Krushë e Vogël, Prizren.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:


V E N D I M

Përfundim të Procedurës Administrative të kërkesës së kompanisë "Start Projekt" Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren - për shfrytëzimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit në ngastren kadastrale P-71813053-02297-0 në Z.K., Krushë e Vogël, Prizren.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të Kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Start Projekt" Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren - për shfrytëzimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit në Krushë e Vogël, Prizren, është konstatuar se mungon dokumentacioni në vijim:

Faqe 2 nga 4



-Sipas njoftimit zyrtar nga DUPH e Komunës së Prizrenit (Nr. 04-353/01-0010255), te datës 04.03.2026, parcela nr. P-71813053-02297-0 (arë e klasës 4) bën pjesë në Zonën Bujqësore - Zb. Aktivitetet minerare dhe industriale nuk lejohen në këtë zonë sipas Hartës Zonale 2022-2030. Operatori duhet të sjellë pëlqimin/vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës nga bujqësore në industriale/minerare;

-Duhet të dorëzohet Kopja e Planit e re dhe certifikata e pronësisë ku përfshihet pjesa grafike e saktë, pasi Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e ka pasur të pamundur verifikimin e saktë të lokacionit në terren për shkak të mungesës së koordinatave grafike;

-Plani i situacionit me koordinatat (largësia nga vendbanimet);

-Mangësitë Teknike dhe Gabimet e Raportit të VNM-së (Pastrohet nga "Copy-Paste")

-Raporti përmban gabime të rënda të kopjuara nga projekte të tjera. Duhet të largohet referenca për "Komunën e Novo Bërdës" (faqe 30) dhe ndikimi në "Lumin Topilla" (faqe 17), pasi lokacioni real është në Krushë të Vogël, Prizren, në afërsi të Lumit Drini i Bardhë.

-Të fshihen referencat e vjetruara si Ligji për Mbeturinat Nr. 04/L-060 dhe të harmonizohet i gjithë teksti vetëm me ligjet e reja në fuqi (p.sh. Ligji Nr. 08/L-071 për Mbeturinat).

-Të fshihet akronimi i gabuar "MMPHI" në të gjithë dokumentin dhe të zëvendësohet me emërtimin zyrtar ligjor MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor).

-Raporti duhet të plotësohet me analizën e plotë të alternativave teknologjike dhe gjeografike (përfshirë skenarin pa veprim - "zero alternative"), ashtu siç kërkohet me Ligjin Nr. 08/L-181, duke eliminuar pohimet se faza e projektit ka filluar dhe nuk ka nevojë për alternativa.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, paragrafi 2, 3 dhe 4, kompanisë "Start Projekt" Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren - për shfrytëzimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit në Krushë e Vogël, Prizren, me datën 10.07.2026 i është dërguar njoftim për plotësim dokumentacioni.

Kompania "Start Projekt" Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren me datën 20.07.2026 ka sjellë plotësimin e dokumenteve, mirëpo dokumentet e sjelluara nuk janë në përputhje me kërkesën për plotësim dokumentacioni.



Bazuar në të lartcekurat, Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së merr vendim për **Përfundim të Procedurës Administrative**, për kërkesën për pajisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Start Projekt" Sh.p.k., Krushë e Vogël, Prizren - për shfrytëzimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit në ngastren kadastrale P-71813053-02297-0 në Z.K., Krushë e Vogël, Prizren.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Vërejtje: Vonesat në kthimin e përgjigjes janë shkaktuar për shkak të volumit të madh të kërkesave dhe ndërrimit të Komisionit për VNM.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/1612/- ZSP/ /26 datë: 28.08.2026

Prishtinë



Bajram Kafexholli

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Prizrenit
7. Divizionit për komunikim me publikun
9. Arkivit të MMPH

Faqe 4 nga 4